



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

PËR SHQYRTIMIN E PROPOZIMIT PËR NDRYSHIMIN E VENDIT TË NUMËRIMIT TË VOTAVE TË ZAZ-SË NR. 9, QARKU KUKËS, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 30.06.2019

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 27.06.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI	Kryetar
Denar	BIBA	Zëvendëskryetar
Bledar	SKËNDERI	Anëtar
Edlira	JORGAQI	Anëtare
Rezarta	BITRI	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për shqyrtimin e propozimit për ndryshimin e vendit të numërimit të votave të ZAZ-së nr. 9, Qarku Kukës, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1 germa "a", nenin 93 dhe 94, pika 1 të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoji diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

V Ë R E N

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr.349 datë 15.05.2019, ka miratuar caktimin e VNV së KZAZ nr.9 në Pallatin e Sportit, salla me sipërfaqe mbi 400 m², qyteti Bajram Curri, Bashkia Tropojë.

Prefekti i Qarkut Kukës, me shkresën nr. 12456 prot., datë 27.06.2019, në ushtrim të përgjegjësisë, bazuar në përcaktimet e ligjit 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", propozon ndryshimin e vendndodhjes së:

- VNV-së së ZAZ nr. 9 nga Pallati i Sportit, Bashkia Tropojë, në ambientet "Euro Bushi" në pronësi të z.Bekim Hajdarmataj, me sipërfaqe mbi 200 m².



Nr. 882 i Vendimit Data 27.06.2019 e Vendimit Ora 10:00 e Vendimit

Për shqyrtimin e propozimit për ndryshimin e vendit të numërimit të votave të zaz-së nr. 9, Qarku Kukës, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019

Kryetari i Bashkisë Tropojë, e ka bërë publike kërkesën për lirimin e ambientit në përgjegjësi administrimi, ambient ku administrata zgjedhore, KZAZ-së nr. 9, ushtron funksionin publik për përgatitjen e procesit zgjedhor të datës 30.06.2019, kërkesë e adresuar shkresërisht edhe në KQZ (nr.11794 prot., datë 17.06.2019).

Propozimi dhe objekti i paraqitur nga Prefekti i Qarkut Kukës, plotëson kushtet e përcaktuara në Udhëzimin e KQZ nr. 4, datë 09.04.2015 "Për mënyrën e caktimit dhe organizimit të Vendit të Numërimit të Votave, kriteret për caktimin e numrit të Grupeve të Numërimit për çdo Vend të Numërimit të Votave, përcaktimin e rregullave për ndarjen e detyrave midis anëtarëve të grupit të numërimit".

ZAZ nr. 9 ka në juridiksionin e saj 50 QV, dhe në bazë të përcaktimeve të Udhëzimit të KQZ-së nr. 4, datë 9.04.2015, duhet të ketë sipërfaqe prej jo më pak se 150 m².

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 23, pika 1 germa "a", nenin 93 dhe 94, pika 1 të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar:

V E N D O S I

1. Të caktojë Vendin e Numërimit të Votave të ZAZ-së nr. 9, në ambientin "Euro Bushi" në pronësi të z.Bekim Hajdarmataj, me sipërfaqe mbi 200 m², Bashkia Tropojë.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Klement ZGURI Kryetar

Denar BIBA Zëvendëskryetar

Bledar SKËNDERI Anëtar

Edlira JORGAQI Anëtare

Rezarta BITRI Anëtare



Nr. 882 i Vendimit Data 27.06.2019 e Vendimit Ora 10:00 e Vendimit

Për shqyrtimin e propozimit për ndryshimin e vendit të numërimit të votave të zaz-së nr. 9, Qarku Kukës, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019